



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr _____ prot

Gramsh, më 20/05/2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data 20.05.2019

Për: Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë - “B 93 II”sh.p.k & “Meteo” sh.p.k. Adresa: Njësia Bashkiake nr.5,Rruga “Ismail Qemali”,Pall.3/162,kati 4,Ap.10,Tiranë & NJA Pishaj,pasuria 6/76,pranë uzinës, Çekin”,Gramsh .

Procedura e prokurimit: “Kërkese për propozime”,me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-15325-03-26-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi i tregut të qytetit” me afat 90 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike 01/04/ 2019 [Nr. 13]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

* * *

1. **BOE - “Aurora Konstruksion”sh.p.k&”Everest” sh.p.k** me nr.Nipti K02017003I & J78311921L me vlerë të ofertës 7 907 255 (shtatëmilionë e nëntëqind e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë)lekë,pa TVSH.
2. **Shoqëria- “Avduli”sh.p.k** me nr.Nipti J66703306O me vlerë të ofertës 6 245 576 (gjashtëmilionë e dyqind e dyzetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë)lekë,pa TVSH.
3. **BOE- “B 93 II”sh.p.k & “Meteo” sh.p.k” sh.p.k** me nr.Nipti L52209050O & L26310801C me vlerë të ofertës 7 998 955 (shtatëmilionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë,pa TVSH.
4. **Shoqëria- “Elda VL”sh.p.k** me nr.Nipti K67106202Ë me vlerë të ofertës (nuk ka dorëzuar ofertë)
5. **Shoqëria- “Viante Konstruksioni”sh.p.k** me nr.Nipti K47103804L me vlerë të ofertës 7 416 512.3 (shtatëmilionë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e dymbëdhjetë pikë tre)lekë,pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm :

1. **BOE - “Aurora Konstruksion”sh.p.k&”Everest” sh.p.k,përkatësisht për arsyet:**
 - Shoqeria “Everest“ shpk nuk ka dorëzuar Vertetimin per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2017 dhe 2018 ne kundërshtim me piken 2.1 te Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit.
 - BOE nuk është i pajisur me **Leje Mjedisore Tip C** lëshuar nga Qendra Kombëtare e

Licensimit për stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme (**Kodi III.1.A**) ose Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të këtë kontratë për depozitim të mbetjeve jo të rrezikshme me një subjekt të licensuar nga ana e QKL në kundërshtim me pikën 8 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.

- Shtojca 4 “Mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” është e paplotesuar me emrin/at e Personit/ave në cilësinë e **anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik**, nga të dy operatorët ekonomikë anëtarë të bashkimit.
 - Nuk është plotësuar saktë nga anëtarët të bashkimit “*Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1*” është plotësuar pika 6 germa „a“ nderkohe që duhej plotësuar pika 6 germa „b“.
 - Të gjitha mjettet në pronësi dhe me qera të subjektit “Everest” shpk nuk janë të shoqëruara me certifikatë transporti mallrash të mjeteve me kapacitet mbajtës 1500 kg e sipër , në kundërshtim me ligjin nr.8308 datë 18.03.1998“Për transportet rrugore“, i ndryshuar nëni 41 i tij.
- 2. Operatorin ekonomik - “Avduli”sh.p.k, përkatësisht për arsyt:**
- Ka detyrime të papërmbushura ndaj bashkisë Gramsh lidhur me garancinë e punimeve për kontratën nr.4245 datë 19.06.2017 me objekt “Rikonstruksion i pjesshem i shkollës fillore në fshatin Bicaj,Njesia Administrative Lenie”, për të cilat është venë në dijeni me ane të shkresave nr.151 prot datë 29.01.2018, nr.6035 prot datë 14.09.2018, nr.6444 datë 02.10.2018, dhe nr.2536 datë 11.04.2019. Afati i garancisë së difekteve ka qenë një vit nga lidhja e kontratës afat I cili ka përfunduar me datë 19.06.2018. Bazuar në rekomandimin e APP-se nr.3341/1 datë 20.03.2018 “*Në disa procedura prokurimi, autoritetet kontraktore, kryesisht Bashki, kanë kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim se, nuk ka detyrime ndaj vetë autoritetit kontraktor si: taksat vendore, gjokat e ndryshme nga autoritet audituese legjitime, si dhe çdo lloj detyrimi tjetër të parashikuar në legjislacionin në fuqi. për sa kohë që autoriteti kontraktor e disponon këtë informacion, ky kriter nuk është i nevojshëm të vendoset*” .
 - Nga verifikimi konstatohet se operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacion për 2 (dy kamioncina) të cilat sipas lejes e qarkullimit janë 3500 kg , nderkohe referuar pikës 10 paragrafi 3, të Kriterëve të kualifikimit 2 kamioncinat janë kërkuar nga 1-3 ton.

3. Operatorin ekonomik - “Elda VL”sh.p.k, përkatësisht për arsyt:

- Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstatohet se ky OE **nuk** ka dorëzuar asnjë dokument lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor si dhe nuk ka dorëzuar oferte .

4. Operatorin ekonomik - “Viante Konstruksioni”sh.p.k, përkatësisht për arsyt:

- Nuk ka dorëzuar vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2018 për bashkinë Tiranë në kundërshtim me pikën 2.1 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit. Vërtetimi i dorëzuar nr.280910/1 datë 24.12.2018 leshuar nga bashkia Tirane parashikon shlyerjen e detyrimeve ndaj bashkisë deri më 20.12.2016.
- Në adresën e përcaktuar nga ankuesi në dokumentat e tenderit , pas verifikimit të kryer konstatohet se një pjesë e mjeteve të deklaruara në shtojcën nr.9 në pronësi të ankuesit nuk ndodhen në vendin e përcaktuar .
Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE konstatohet se mjeteve me targa AA541SI, AA812 RK, AA 937 KC , u ka përfunduar afati i siguracionit dhe kolaudimit, AA315 DF i ka përfunduar siguracionin, autobotit me targa AA278 LN ka përfunduar afati i siguracionit dhe kolaudimit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **informojmë BOE- “B 93 II”sh.p.k & “Meteo” sh.p.k” sh.p.k**,me adresë Njësia Bashkiake nr.5,Rruga “Ismail Qemali”,Pall.3/162,kati 4,Ap.10,Tiranë & NJA Pishaj,pasuria 6/76,pranë uzinës, Çekin ”,Gramsh, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **7 998 955 (shtatëmilionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë,pa TVSH**, pikët totale të marra [____], është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Gramsh**, Bulevardi “10 korriku”,Sheshi “Kamber Dërmyshi “ ,pranë Njesisë së Prokurimit,kati tretë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [____], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.04.2019.

Ankesa: Më datë 30.04.2019 brenda afatit ligjor regjistrohet ankesa nr.2808 prot nga ana e operatorit ekonomik “Viante Konstruksion ” shpk ,dhe më datë 03.05.2019 regjistrohet ankesa nr.2877 prot nga ana e operatorit ekonomik “Avduli ” shpk .

Pas shqyrtimit të ankesës komisioni i shqyrtimit të ankesës vendosi të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Viante Konstruksion ” shpk dhe të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Avduli ” shpk,vendim i cili iu komunikua shkresërisht dhe në rrugë elektronike në SPE. Operatorët ekonomikë ankimes kanë marrë njoftim më datë 08.05.2019.

Pas përfundimit të afatit të ankimit në KPP rezultoi se nuk pati ankesë në KPP .

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI

LULJETA DOLLANI

Konceptoi: E.Guzi

Miratoi: E.Guzi

Konfirmoi:

Dosja nr: _____

Afati i ruajtjes: _____